

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit V.B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.3518/2015 të datës 15.03.2016, pas mbajtjes së seancës fillestare në praninë e prokurorit të shtetit në Prizren B.Sh. dhe të akuzuarit, me datë 17.08.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

V.B. nga i ati H. dhe e ëma Gj. e lindur ..., i lindur më datë 13.05.1991 në Prizren ku edhe tani jeton rruga “...” pa nr., ka të kryer fakultetin ekonomik – drejtimi marketing ekonomi, ekonomist, i martuar, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendjes së varfër ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

Me datë 05.11.2015 rreth orës 09:00, në Prizren rrugën “...”, si pjesëmarrës në komunikacionin rrugor, nga pakujdesia e rrezikon trafikun publik jetën e njerëzve dhe pasurinë, gjatë drejtimit të automjetit të udhëtarëve markës “Opel Kadet” me targa të regjistrimit ..., vepron në kundërshtim me nenin 54 të LSKRR, kur arrin në vendin kritik, shpejtësinë e lëvizjes nuk i përshtat kushteve dhe rrethanave në rrugë si dhe nuk ka pasur kujdes të shtuar në vendbanim sidomos ndaj këmbësorëve, kur vjen afër shkollës fillore “...” me pjesën e përparme të anës së djathtë të automjetit e godet këmbësoren A.K., e cila në momentin kritik tenton ta kalon rrugën nga ana e djathtë në anën e majtë të drejtimit të lëvizjes së automjetit, me ç’rast e dëmtuara pëson lëndime trupore dhe atë: ndrydhje - mbretje të indeve të buta në regjionin e parakrahut të dorës së majtë dhe pjesën e sipërme të regjionit të kërcirit – nën gjurit të këmbës së majtë, të cilat lëndime kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor me pasoja të përkohshme të shëndetit.

Kësodore ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK.

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 43, 46, 73 dhe nenit 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK, të akuzuarit i shqipton dënimin dhe atë:

D Ë N I M M E G J O B Ë

Në shumë prej 200 € (dyqind euro), i cili dënim duhet të paguhet 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse dënimi me gjobë nuk ekzekutohet në afatin ligjor i njëjti do të zëvendësohet me 10 (dhjetë) ditë dënim burgu duke llogaritur për 20 € një ditë burg.

E dëmtuara A.K. nga Prizreni rruga “...” nr.... në përmjet përfaqësuesit ligjor – prindit H.K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës dhe atë në emër të ekspertizës për ekspertin e komunikacionit shumen prej 40.88 €, në emër të shpenzimeve të ekspertit mjeko ligjore për ekspertizë shumen prej 20 €, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.3518/2015 të datës 15.03.2016, kundër të akzuarit V.B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akzuarit. I akuzuari nuk e kundërshtoj provat materiale të cilat janë pjesë e shkresave të lëndës dhe pranoj fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike me datë 05.11.2015 në ora 09:00, në Prizren rrugën "...", i akuzuari V.B. si pjesëmarrës në komunikacionin rrugor, ka drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës "Opel Kadet" me targa të regjistrimit ... shkel ligjin mbi trafikun publik, vepron në kundërshtim me nenin 54 të LSKRR, nga pakujdesia e rrezikon trafikun publik e vë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, nuk përmbahet rregullave të komunikacionit, shpejtësinë e lëvizjes nuk i përshtat kushteve dhe rrethanave në rrugë si dhe nuk ka pasur kujdes të shtuar në vendbanim sidomos ndaj këmbësorëve, kur arrin në vendin kritik – afër shkollës fillore "... " me pjesën e përparme të anës së djathtë të automjetit e godet këmbësoren A.K. e cila në momentin kritik tenton ta kalon rrugën nga ana e djathtë në anën e majtë të drejtimit të lëvizjes së automjetit, e dëmtuara pëson lëndime trupore dhe atë: ndrydhje - mbretje të indeve të buta në regjionin e parakrahut të dorës së majtë dhe në pjesën e sipërme të regjionit të kërcirit – nën gjurit të këmbës së majtë, të cilat lëndime kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor me pasoja të përkohshme të shëndetit.

Gjykata para se të hap seancën fillestare bëri shikimin e shkresave të lëndës dhe analizën e provave materiale dhe atë: ekspertizën e ekspertit të komunikacionit Inxhinier A.O. të datës 28.02.2016, ekspertizën e ekspertit të mjeksisë ligjore Dr. V.K. të datës 26.02.2016, raportin mjeksësor i Spitalit Rajonal në Prizren – Qendrës Emergjente me numër të protokolit ... datës 05.11.2015, skicën e vendit të ngjarjes dhe foto dokumentacionin, me ç'rast është vërtetuar se provat janë marrë në pajtim me dispozitat e kodit të procedurës penale dhe aktakuzën e prokurorit të shtetit e bëjnë të qëndrueshme dhe e bazuar në ligj. Provat në fjalë me kohë janë parashtruar të akzuarit me qëllim që të njëjtat të kundërshtoj dhe të parashtroj prova tjera të cilat do të shkojnë në favor të gjendjes faktike dhe mbrojtjes së tij. Mirëpo në seancën fillestare pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i akuzuari deklaroj se ka kuptuar aktakuzën dhe nuk e kundërshton provat në të cilat mbështete aktakuza dhe e pranon fajësinë për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK. Prandaj pasi që i akuzuari

në seancën fillestare pranoj fajësisë dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht, e cila mbështet në fakte dhe prova materiale, të cilat prova i akuzuari nuk i kundërshtoj, gjykata konsideroj se janë plotësuar kushtet ligjore nga nenit 246 të KPPK dhe ka ardhur në përfundim se në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenësore të veprës penale e përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpalli fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysht të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarin morri parasysht faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunim me organet e drejtësisë, sjellja korrekte e akuzuarit gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi për kryerjen e veprës penale, gjendja materiale dhe statusore është mbajtës i familjes, kjo është hera e parë që bie ndesh me ligjin, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoj dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla, me bindje se është proporcionale me peshën e veprës penale, për të cilën i akuzuari është shpall fajtor.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarës në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, gjykata e morri në pajtim me nenin 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.844/2017 të datës 17.08.2017

Procesmbajtësja
Myrvete Përdibuka

Gjyqtarja
Teuta Krusha

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.